



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 262, Datë 19.12.2018**

**MBI**

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 188, DATË 10.11.2017,  
“PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ SH.A NË AKTIVITETIN E  
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar; nenit 3, pika 50; nenit 22, pika 2, gërmat a) dhe b), të Ligjit Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”; nenit 113 pika 3, të Ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 4, pika 1, gërmat a) dhe b); nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror” të ndryshuar

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me vendimin nr. 188, datë 10.11.2017 . ka vendosur “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sha në veprimtarinë e **transmetimit** së gazit natyror” i ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 178, datë 20.08.2018.
- Me shkresën nr. 495/1 Prot., datë 23.08.2018, ERE ka përcjellë pranë “Albgaz” sh.a njoftimin e vendimit nr. 178, datë 20.08.2018, të sipërcituar, duke i bërë me dije edhe detyrimin për depozitimin e dokumentacionit të munguar **brenda datës 20.12.2018.**
- Sa më sipër, shoqëria “Albgaz” sh.a i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 88/1 Prot., datë 14.12.2018 (protokolluar në ERE me nr. 495/3, datë 17.12.2018), me anë të së cilës ka kërkuar shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar **deri në datën 04.03.2019** duke informuar ERE-n mbi përditësimin e procedurave të dokumentacionit për pajisjen me çertifikatën e pronësisë për, Sheq i Madh, Fier Drizë, Fier Gjonçe, Lavdan.
- Për pasuritë Cërrik, Drenovë, Mallakastër Balldren, Mallakastër, Albgaz sh.a infomon ERE-n se ka bërë kërkesë në Z.V.R.P.P. përkatëse, në kuadër të mundësimit të ecjes me ritme të shpejta në procesin e regjistrimit të asetëve.

- Me qëllim plotësimit e dokumentacionit shoqëria “Albgaz” sh.a informon ERE-n se ka aplikuar për transferimin e lejes Mjedisore të (Tipi A) pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe është ende në pritje.
- “Albgaz” sh.a duke risjellë në vëmendje edhe ndryshimet në drejtimin e shoqërisë si dhe strukturave të ministrive nga të cilat ka varësi, bën me dije se po merr të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e pikave të kërkuara nga vendimet e sipërcituara.
- Albgaz sh.a kërkon nga ERE shtyrjen e afateve të dërgimit të dokumentacionit të munguar të vendimeve sipërcituar, mundësisht deri në datën 04.03.2019.
- Çështjet e parashtruara për të cilat kërkohet shtyrja e afateve të paraqitjes është jashtë vullnetit të Albgaz sh.a për realizimin e tyre në kohë, pasi janë kompetencë e institucioneve të tjera përgjegjëse. Duke qenë të tilla duhet të reflektohen ndryshimet e kërkuara nga Albgaz sha, në afatet e vendosura në vendimin për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

### **Vendosi:**

1. Të miratojë një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror” të ndryshuar, si më poshtë:

- *“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30 vjeçar, me kushtin që brenda datës 04.03.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë gjithë dokumentacionin e munguar...”*

2. Drejtoria e e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë Albgaz sh.a për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**